

MA Fikrie BERISHA

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës

PERIODIZIMI I FONDEVE DHE KOLEKSIONEVE PERSONALE NË ARKIVAT E KOSOVËS

Abstrakt: *Zhvillimi i ngjarjeve historike, politike ushtarake, shkencore krijuese, artistike gjatë një etape të caktuar kohore nxjerr personalitete të dalluara, në nivel shtetëror dhe kombëtar. Këto personalitete lënë pas vetes një trashëgimi të rëndësishme në formën e materialeve dokumentuese, të cilat me kalimin e kohës marrin rëndësinë e një fondi arkivor personal që është me rëndësi për arkivistikën dhe studiuesit e fushave të ndryshme.*

Sikurse lënda arkivore publike, po ashtu edhe fondet dhe koleksionet personale arkivore bëjnë pjesë në kategorinë e asaj që ne e cilësojmë si memorie e një shteti, përkatësisht e një populli ose shoqërie. Një burim ose mënyrë e pasurimit të fondit të përgjithshëm shtetëror pa dyshim që është edhe grumbullimi i dokumenteve me pronësi private.

Arkivat e Kosovës, përveç se ruajnë një numër të konsiderueshëm të këtyre fondeve dhe koleksioneve, vazhdojnë të pasurohen më këto lloj dokumentesh.

Për të pasur një qasje më të lehtë bulumtuesit për qëllime shkencore në këto fonde dhe koleksione, si dhe të interesuarit e tjerë, rëndësia e periodizimit të tyre bëhet gjithnjë më e nevojshme dhe e domosdoshme. Prandaj, kumtesa jonë synon të shpjegojë dhe të analizojë pikërisht periodizimin e fondeve dhe koleksioneve arkivore në arkivat e Kosovës.

Fjalë çelës: *Fonde personale arkivore, koleksione personale arkivore, grumbullim, periodizim i fondeve dhe koleksioneve personale arkivore.*

Hyrje

Një burim tjetër mjaft interesant dhe i rëndësishëm i pasurimit të arkivave është edhe grumbullimi i dokumenteve me pronësi private. Arkivat e shtetit,

sikurse kanë obligim ndaj dokumenteve publike, po ashtu kanë obligim ligjor edhe për materialin me pronësi private. Tema “Periodizimi i fondeve dhe koleksioneve personale në arkivat e Kosovës” mendoj që është një fushë shumë interesante dhe tërheqëse për arkivistët dhe arkivistikën sepse trajton në vetvete një aspekt krejtësisht të veçantë nga fondet tjera. Arkivat e Kosovës, përveç se ruajnë një numër të konsiderueshëm të këtyre fondeve dhe koleksioneve, vazhdojnë të pasurohen në vazhdimësi me këto lloj dokumentesh. Qëllimi i periodizimit të këtyre fondeve është sepse lehtëson punën e hulumtuesve dhe atyre që shprehin interesim për shfrytëzim të këtij materiali. Prandaj dhe trajtimi ynë synon që të shpjegojë dhe të analizojë pikërisht periodizimin e fondeve dhe koleksioneve arkivore në arkivat e Kosovës.

Përqendrimi im në këtë kumtesë është kryesisht hulumtimi dhe evidentimi i fondeve dhe koleksioneve personale të cilat janë dorëzuar në Arkivin Shtetërorë të Kosovës (ASHAK) dhe arkivat ndërkomunalë. Fillimisht jam marrë me shqyrtimet konceptuale dhe *definimin* e fondeve personale. Çështja e cila më kishte intriguar për ta shtruar për hulumtim ishte: A ka pasur rritje të dorëzimit të fondeve arkivore personale në Kosovën e pas luftës?

Fillimisht kam bërë konstatimin e gjendjes aktuale të fondeve dhe koleksioneve të dorëzuara duke u fokusuar në trajtimin dhe analizën e ndarjes kohore të tyre përmes etapave historike, të cilat njëkohësisht përfaqësojnë edhe pushtetet dhe rendet shoqërore që kanë ekzistuar gjatë etapave historike, dhe tendencat e zhvillimit të mëtejme. Për trajtimin e kësaj çështjeje kam shfrytëzuar literaturën ekzistuese të të dhënave, duke u bazuar në metodën historike krahasuese. Në punim gjithashtu kam futur edhe grafikun e tabelave me qëllim që etapat kohore të jenë më të qarta dhe më të kuptueshme.

Punimi është ndarë në tre kapituj: Përkufizimi i fondeve dhe koleksioneve personale arkivore; Fondet dhe koleksionet personale arkivore në arkivat e Kosovës; Analiza e gjetjeve si dhe Përfundimet (Konkluzionet). Është struktura e lëndës hulumtuese ajo që ka determinuar ndarjen e kapitujve të punimit.

I. Përkufizimi i fondeve dhe koleksioneve personale arkivore

Para se të thellohem në trajtimin e çështjes, është e rëndësishme që të bëjmë përcaktimin dhe krahasimin e koncepteve kyçe për fondet personale arkivore d.m.th,

të përcaktojmë çka nënkuptojmë me fonde dhe koleksione personale. Pra me *Fond personal* (familjar ose fisnor) nënkuptojmë tërësinë e dokumenteve të krijuara gjatë veprimtarisë së një personi, të një familjeje ose të një fisi.¹ Afërsisht edhe nocioni koleksion ka pothuajse të njëjtën natyrë dhe rëndësi për temën që po trajtojmë. Pra, me *Koleksion* nënkuptojmë mbledhjen artificiale të dokumenteve sipas kritereve të zakonshme, në bazë të ndonjë karakteristike të përbashkët, grumbullimi i të cilave është rezultat i vullnetit apo rastësisë krahasuar me dokumentet e krijuara në mënyrë organike nga ndonjë fondkrijues.² Për dallim nga ne, në literaturën ndërkombëtare përdoret edhe koncepti i letrës si dokument p.sh., “Letrat personale” (gjithashtu të dhënat personale, dokumentet private), që janë: 1. Dokumentet e krijuara, të fituara ose të marra nga një individ gjatë rrjedhës së punëve të tij ose asaj dhe që ruhet sipas rendit të tyre origjinal (nëse ekziston një urdhër i tillë); 2. Dokumentet jozyrtare të mbajtura nga një individ në një vend pune.³

Një përjasje mjaft interesante që është bërë nga teoricienët e arkivistikës për ta pasur më të qartë konceptin e fondeve personale është marrja për objekt studimi e fondeve arkivore personale të shkrimtarëve. Për shkak se kategoria e arkivave personale përfshin një numër të madh të llojeve të të dhënave dhe të dhëna të vetë krijuesve, herët në kërkimin tim zgjodha për t’u përqendruar hollësisht në një nëngrup krijuesish të arkivave personale, si shkrimtarët. Arkivat e shkrimtarëve ofrojnë një pikënisje të favorshme për studimin e të dhënave të krijuara nga individët, sepse në radhë të parë ato janë gjithandej nëpër arkiva, biblioteka dhe në imagjinatën kulturore. Adrian Cunningham thekson se me anë të profesionit të tyre “shkrimtarët japin më shumë të dhëna dhe janë ruajtës më të mirë të të dhënave” si dhe arkivat e shkrimtarëve është mjaft lehtë të ruhen në sasi të mëdha në depo të arkivave dhe biblioteka speciale për koleksione”.⁴

Gjatë përpunimit të fondeve arkivore personale është pothuajse e pamundur të jesh indiferent dhe t’i shmangemi ndikimit subjektiv dhe emocional që krijon arkivisti me fondkrijuesin, pasi ato materiale shpesh paraqesin botën (jetën) intime, e cila ka mundësi që me vite të tëra është ruajtur dhe mbajtur larg nga vëmendja e publikut të gjerë. “Arkivat personale përmbajnë pikëpamje personale të përvojave të jetës; ata përfaqësojnë një largim nga formaliteti kolektiv dhe organizimi sistematik që haset tektë dhënat e llojeve të tjera të dokumenteve. Në arkivin

personal ka një intimitet i cili nuk është i pranishëm në atë kolektiv, mes korporatave dhe në sistemin zyrtar të ruajtjes së të dhënave. Këto elemente intime reflektohen jo vetëm në përmbajtjen dhe organizimin e të dhënave personale, por hyjnë në lojë dhe bashkëveprim të drejtpërdrejtë të arkivistit me krijuesin / donatorin gjatë vlerësimit, blerjes dhe menaxhimit të mëvonshëm të arkivave personale”.⁵

Duke e ditur rëndësinë e fondeve personale arkivore për fondin e përgjithshëm të arkivave dhe trashëgiminë me vlerë të këtij fondi, ligjvënësi e ka rregulluar këtë çështje me ligje dhe udhëzime administrative. Kjo çështje aktualisht trajtohet në Nenin 17 të Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2007. “Lënda arkivore private pranohet në arkiv në bazë të dokumentit të shkruar (kontratës, shkresave zyrtare ose testamentit), në të cilën janë përcaktuar të drejtat dhe obligimet e palëve”.⁶ Ekziston një dallim mes arkivave private dhe fondeve personale. Prandaj është e rëndësishme të dimë të bëjmë dallimin konceptual mes tyre. Fondet personale arkivore janë dokumente që krijohen nga një individ ose familje e caktuar për dallim nga arkivat private të cilat janë institucione që ruajnë lëndën arkivore, p. sh., të kompanive të ndryshme private, pastaj shoqatave të ndryshme e kështu me radhë. Vetëm mbasi të dorëzohen në arkivat shtetëror ato bëhen pronë e arkivit si çdo fond tjetër.

II. Fondet dhe koleksionet arkivore personale në Kosovë

Sa i përket trashëgimisë së fondeve dhe koleksioneve personale arkivore në arkivat tona tashmë ekziston një traditë, siç ekziston edhe tradita e dorëzimit të tyre si në arkivin qendror, po ashtu edhe nëpër arkiva ndërkomunalë. Për hir të së vërtetës, nuk mund të themi se ekziston literaturë e bollshme e cila do të mund të na shërbente si burim dytësor për të konstatuar gjendjen dhe sasinë e këtyre fondeve, megjithatë ne kemi konsultuar literaturën bazë dhe të fundit e cila trajton këtë fenomen e që është Udhërrëfyesi i Fondeve dhe Koleksioneve të ASHAK-së, i botuar në fund të vitit 2017.

Gjatë trajtimit të ndarjes së këtyre fondeve në ASHAK, kemi bërë periodizimin historik në katër periudha të mëdha kohore dhe historike, të cilat njëkohësisht përcaktojnë edhe sistemet qeverisëse gjatë historisë në vendin tonë. Kështu, p. sh.:

- etapa deri në vitin 1912 - periudhë kjo e cila përfshin kohën e sundimit të

Perandorisë Osmane;

- etapa pas 1912 deri më 1945 - periudhë të cilën historia e njeh si periudha e sundimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene;
- etapa pas vitit 1945 deri më 1999 - periudha e sundimit të ish-Federatës Jugosllave dhe asaj që është proklamuar si trashëgimtare e saj e Serbisë, dhe
- ajo pas vitit 2000 - periudha e Kosovës së çliruar dhe të pavarur.

Për ta bërë më të kuptueshme dhe më të kapshme për lexuesit dhe studiuesit e mundshëm kam bërë edhe prezantimin në formë grafike (tabelare).

Të dhënat e paraqitura në tabelën numër 1 janë fondet dhe koleksionet e dorëzuara, të cilat janë të listuara dhe të skeduar pranë ASHAK-së⁷.

Tabela Nr. 1 / Evidenca e dorëzimit të fondeve dhe koleksioneve personale në ASHAK														
Fonde dhe koleksione personale të ndara sipas etapave historike														
Nr .	Periudha historike	Kuti	Fashikuj	Fletë	Dokumente	Fotografi	Fletore	Rrolle mikrofilm	Faqe skanimi	Harta	Vula	Libër	Dekoratë	Material tjetër
1	deri 1912	31	4	7	91	35	1	-	-	23	-	1	1	-
2	deri 1945	13	3	17	19	-	-	1	-	-	19	-	-	-
3	deri 1999	121	-	521	4	958	-	-	-	23	-	-	-	-
4	pas 2000	7	2	-	-	-	-	-	3467	-	-	-	-	-
	Gjithsej	172	9	545	114	993	1	1	3467	46	19	1	1	

Tabela 1-Evidenca e dorëzimit të fondeve dhe koleksioneve personale në ASHAK

Materiali i paraqitur në tabelën Nr. 2 ka të bëjë me fondet që ekzistojnë në arkivat ndërkomunalë deri më 2017. Të dhënat e paraqitura në këtë tabelë janë paraqitur pa periodizimin e tyre nëpër etapa historike sikurse në tabelën e parë për faktin se ato nuk kanë një numër të madh fondesh brenda inventarit të tyre. Në këtë tabelë janë përfshirë në total të dhënat e gjashtë arkivave ndërkomunalë.

Tabela Nr. 2 / Evidenca e fondeve dhe koleksioneve personale në arkivat ndërkomunalë															
Fonde dhe koleksione personale të periudhës historike deri më 2017															
Nr.	Emri i arkivit	Kuti	Fashikuj	Fletë	Dokumente	Fotografi	Fletore	Rrollne mikrofilm	Faqe të skanuara	Harta	Vula	Libër	Dekoratë	Material tjetër	Periudha historike
1	Ark.Ndërkom. i Prishtinës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
2	Ark.Ndërkom. i Prizrenit	-	-	-	-	-	-	1m	-	-	-	-	-	-	1999
3	Ark.Ndërkom. i Pejës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
4	Ark.Ndërkom. i Mitrovicës	16	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
5	Ark.Ndërkom. i Gjilanit				18										1945
				157										5dvd	1999
								40 cm							
6	Ark.Ndërkom. i Gjakovës	8	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	S'ka vite
Gjithsej		24	-	157	18	-	-	1.4m	-	-	-	-	-	5dvd	

Tabela 2-Evidenca e fondeve dhe koleksioneve personale në arkivat ndërkomunalë

Pavarësisht volumit, për hir të analizës procesi i evidentimi dhe krahasimit është ndjekur me procedurë normale, edhe pse në disa arkiva ndërkomunalë nuk rezulton as si fenomen dorëzimi i fondeve personale arkivore.

III. Analiza e gjetjeve

Në këtë kapitull është bërë përmbledhja e fondeve në totalin e tyre ku janë përfshirë fondet dhe koleksionet e ASHAK-së dhe ato të arkivave ndërkomunalë duke evidentuar edhe llojet e materialit arkivor që janë dorëzuar. Lloji ose formati i lëndës arkivore që është dorëzuar më shumë janë: dokumente me faqe të skanuara, fotografitë, fletë me rëndësi arkivore, kuti me dokumente të ndryshme po ashtu të skanuara, dhe kështu me radhë. Kjo mbase për shkak të ndikimit të zhvillimit të teknologjisë dhe përdorimit të kompjuterëve. Është e çuditshme se dokumenti në format libri dhe fletoreje rezultojnë shumë pak, vetëm me nga një ekzemplar të dorëzuar, kur kemi parasysh se fletorja p. sh., ka qenë mjet shumë i hershëm ku është shkruar dhe krijuar gati gjithçka. Nga ana tjetër, vëmë re se edhe materiale të formatit të filmuar janë dorëzuar numër shumë i vogël, duke pas parasysh që të paktën, në historinë më të re, për shumë ngjarje me rëndësi qytetarët posedojnë filmime personale. Kjo ndoshta për arsye se poseduesit individual mendojnë se

këtë lloj të video-dokumentacionit mund ta ruajnë dhe transmetojnë brenda brezave të familjes më lehtë sesa llojet e tjera të dokumenteve ose artefakteve.

Tabela Nr. 3/ Evidenca e fondeve dhe koleksioneve personale të ASHAK-së dhe arkivave ndërkomunalë														
Fonde dhe koleksione personale të periudhës historike deri më 2017														
Nr .	Emri i arkivit	Kuti	Fashikuj	Fletë	Dokumente	Fotografi	Fletore	Rrollne mikrofilm	Faqe të skanuara	Harta	Vula	Libër	Dekoratë	Material tjetër
	ASHAK	172	9	545	114	993	1	1	3467	46	19	1	1	
	Arkivat ndërkomunalë	24	-	157	18	-	-	1.4m	-	-	-	-	-	5dvd
	Gjithsej:	196	9	702	132	993	1	2.4m	3467	46	19	1	1	5dvd

Tabela 3 -Evidenca e fondeve dhe koleksioneve personale të ASHAK-së dhe arkivave ndër komunalë

Sipas kësaj pasqyre tabelare dhe mbas hulumtimit të bërë, logjikshëm nxjerrim përfundimin se: përkundër mendimit dhe pritshmërisë që pas vitit 2000 të ketë pasur më shumë vullnet për dorëzim të fondeve dhe koleksioneve personale në arkivat shtetërorë, në fakt nuk rezulton ashtu. Pra, individët dhe familjet që posedojnë fonde dhe koleksione personale arkivore nuk janë treguar shumë zemërgjerë për sa i përket dorëzimit të eksponateve të tyre nëpër arkivat shtetërorë.

Ajo që vihet re se shënon rritje mbas vitit 2000 janë faqet e skanuara të dokumenteve. Sigurisht që, nuk pretendojmë se me këtë trajtim që kemi bërë përmes këtij punimi ta kemi shterur këtë tematikë. Jo, përkundrazi, unë mendoj që në të ardhmen, specialist të arkivistikës ose ekipe të organizuara dhe me punë të planifikuar, jo vetëm në institucione arkivore, të bëjnë hulumtim duke bërë identifikimin dhe listimin e familjeve dhe individëve, të cilët mund të posedojnë fonde ose koleksione arkivore personale të ndryshme nëpër shtëpitë e tyre.

IV. PËRFUNDIME

Mbas hulumtimit të bërë, i cili është paraqitur edhe përmes tabelave, logjikshëm nxjerrim konstatimin se, përkundër mendimit dhe pritjeve që pas vitit 2000 do të

ketë më shumë vullnet për dorëzim në arkivat shtetërorë të materialeve me pronësi private, në fakt nuk na del ashtu. Ajo që vihet re se shënon rritje pas vitit 200 janë faqet e skanuara të dokumenteve.

Mbas hulumtimit të bërë shohim se dorëzimi më i madh është bërë deri në vitin 1999, periudhë kjo që përshinë sistemin e qeverisjes së ish-Federatës Jugosllave.

Shpresojmë që në të ardhmen me rritjen e besueshmërisë së institucioneve shtetërore dhe sidomos të arkivave të kemi një ndërgjegjësim dhe besim më të madh të qytetarëve dhe të dorëzojnë materialet e tilla nëpër arkiva.

-
- 1 Fjalori shqip i termave arkivore, Tiranë 2015, f. 28.
 - 2 Fjalori shqip i termave arkivore, Tiranë 2015, f. 40.
 - 3 Pearce-Moses, Richard: *A Glossary of Archival and Records Terminology*, The Society of American Archivists, 2005 Chicago, f.292/ <http://files.archivists.org/pubs/free/SAAGlossary-2005.pdf> /, konsultuar on-line më 04.05.2018.
 - 4/ Douglas, Jennifer Lynn: *Archiving Authors: Rethinking the Analysis and Representation of Archives*, Faculty of Information, University of Toronto 2013, fq. 4/ https://tspace.library.utoronto.ca/bitstream/1807/35808/1/Douglas_Jennifer_L_201306_PhD_Thesis.pdf /, konsultuar on-line më 02.05.2018.
 - 5 Hobbs, Catherine: “Personal Archives The Character of Personal Archives: Reflections on the Value of Records of Individuals”, *Archivaria 52* - The Journal of the Association of Canadian Archivists, 2001, fq. 127, konsultuar on-line në: <https://archivaria.ca/index.php/archivaria/article/viewFile/12817/14027> / më 02.05.2018.
 - 6 Udhëzimi Administrativ Nr.09/ 2007 *Për pranimit-dorëzimin e lëndës arkivore*, Neni 17, fq. 9.
 - 7 *Udhërrëfyesi i Fondeve dhe Koleksioneve të ASHAK-së*, Prishtinë, 2017, fq. 33-35.

BIBLIOGRAFI:

Douglas, Jennifer Lynn: *Archiving Authors: Rethinking the Analysis and Representation of Archives*, Faculty of Information, University of Toronto 2013. Konsultuar në: https://tspace.library.utoronto.ca/bitstream/1807/35808/1/Douglas_Jennifer_L_201306_PhD_Thesis.pdf/.

Hobbs, Catherine: "Personal Archives The Character of Personal Archives: Reflections on the Value of Records of Individuals", *Archivaria 52* - The Journal of the Association of Canadian Archivists, 2001. Konsultuar në: <https://archivaria.ca/index.php/archivaria/article/viewFile/12817/14027/>.

Pearce-Moses, Richard: *A Glossary of Archival and Records Terminology*, The Society of American Archivists, 2005 Chicago. Konsultuar në <http://files.archivists.org/pubs/free/SAA-Glossary-2005.pdf/>.

Udhërrëfytyesi i Fondeve dhe Koleksioneve të ASHLAK-së, Prishtinë, 2017.

Fjalori shqip i termave arkivore, Tiranë 2015.

Udhëzimi Administrativ Nr.09/ 2007 Për pranim-dorëzimin e lëndës arkivore, Neni 17.